



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
31.07.2024

Me datë 31.07.2024, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Hedije Nasa, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Alma Mehmetaj, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Izmira Rusi, Irena Shala, Artan Haxhi, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Jetmira Rraboshta, Ervin Brahimi, Suada Kopshti, Erkan Hoxha, Vjoleta Përndrecaj, Ardita Spahija, Gjovalin Ndoj, Samed Bushati, Fatmir Vojvoda, Anita Amuli, Imeldi Sokoli, Amina Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Qershor 2024"*.
2. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga shpenzime korrente tek projektet e investimeve brenda të njëjtit program për vitin 2024"*
3. Pr/Vendim: *"Dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga "World Vision Albania", në cilësinë e donatorit për investimin e projektit "Kënd lojrash".*
4. Pr/Vendim: *"Për miratimin e transferimit të fondit të mbetur gjendje në llogari jashtë thesari, për projektin "Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit" nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 "Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor".*
5. Pr/Vendim: *"Për strehimin emergjent të Znj.XH.B dhe fëmijëve të mitur në njësinë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare "Për familjen"Nr.6 (ish konvikti i Shkollës Pyjore).*
6. Pr/Vendim: *"Dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga subjekti "Raiffeisen Invest", sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investim dhe zbatim në kuadër të "Rikualifikimit të hyrjes së disa shkollave të qytetit, Shkodër.*
7. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Z.Luli citon rendin e ditës, duke sqaruar se rendit të ditës i shtohen edhe dy pika të tjera emergjente:

1. *Pr/Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" i ndryshuar.*
2. *Pr/Vendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarret"*

Para se të hidhet në votim rendi i ditës fjalën e merr **Z.Bjanku** i cili shpreh rezerva lidhur me paraqitjen me vonesë të materialeve. Ai shton se është e pamundur që në një kaq të shkurtër të shihen materialet nga ana e tyre. Shtesa në rendin e ditës janë të parashikuara nga rregullorja, në raste të jashtëzakonshme, emergjente por kjo po bëhet e shpeshtë tashmë dhe nuk është aspak serioze.

Z.Luli sqaron edhe njëherë duke cituar ligjin 139/2015, që Kryetari i bashkisë ka të drejtë të paraqesë pr.vendime shtesë kur shihet e nevojshme.

Edhe **Znj.Shala** shprehet po ashtu lidhur me dy pikat shtesë, me të cilat janë njohur shumë vonë, vetëm një orë para fillimit të mbledhjes. Ajo kërkon në mënyrë të përsëritur të respektohet procedura, pasi po kthehet në precedent.

Znj.Shkrela shprehet se nuk është aspak serioze që pr.vendimet t'i paraqiten këshilltarëve një ose dy ditë përpara mbledhjes. Ajo kërkon gjithashtu që Kryetari i bashkisë duhet të jetë prezent në mbledhjet e Këshillit, pasi me mosprezencën e tij ai po tregon mosrespekt ndaj nesh dhe qytetarëve të Shkodrës.

Fjalën e merr Zv/kryetari **Z.Bejleri**, i cili sqaron se pikat shtesë janë paraqitur në këtë mbledhje pasi janë emergjente, për të cilat nuk mund të pritej edhe një muaj për t'i ardhur në ndihmë financiarisht familjeve të prekura.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë **26** vota Pro **12** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Qershor 2024".*

Siç është rënë dakort, kryetarët e grupeve, mendojnë se ky pr/akt nuk ka nevojë për relativim pasi është i përmuajshëm. Pr/akti hidhet në votim, ku rezultojnë **38** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Grupi i kualicionit "Bashkë Fitojmë" largohet nga salla.

Vijohet me mbledhjen, pasi kourumi i nevojshëm është prezent në sallë me 26 këshilltarë.

Vijohet me pikën e rradhës së rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga shpenzime korrente tek projektet e investimeve brenda të njëjtit program për vitin 2024”*

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Myrtaj**, drejtor i Policisë bashkiake, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **25** vota Pro, **0** Kundër, **1** Abstenim.

Nuk miratohet

Kalohet në pikën e rradhës: Pr/Vendim: *“Dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga “World Vision Albania”, në cilësinë e donatorit për investimin e projektit “Kënd lojrash”.*

Relaton në lidhje me këtë Pr/vendim **Znj.Kruja**, drejtoreshë, drejtoria e Shërbimit Social dhe Strehimit në Bashkinë Shkodër , sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Pode falenderon donatorin “World Vision ” për këtë projekt dhe shpreson që financime të tilla të kemi edhe në të ardhmen. pse jo edhe projekte për moshën e tretë.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **25** vota Pro, **0** Kundër, **1** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 4. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *“Për miratimin e transferimit të fondit të mbetur gjendje në llogari jashtë thesari, për projektin “Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit” nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 “Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor”.*

Relaton përsëri **Znj.Kruja**, drejtoreshë, drejtoria e Shërbimit Social dhe Strehimit në Bashkinë Shkodër , sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Përsëri **Znj. Pode** përgëzon nismën sepse rehabilitimi dhe restaurimi i Qendrave shëndetësore është shumë i rëndësishëm.

Z.Sokoli kërkon të dijë se si është bërë përzgjedhja e qendrave ku do bëhet ndërhyrja?

Edhe **Znj.Gjekaj** mendon se përzgjedhja duhet të ishte bërë me prioritet, pasi ka qendra shëndetësore që kanë nevojë për ndërhyrje më të mëdha, aq më tepër kur kanë numër të madh pacientësh që marrin shërbim aty.

Znj.Kruja përgjigjet duke thënë se kemi bashkëpunuar me “Shërbimin e kujdesit parësor shëndetësor ” dhe duke parë listën e paraqitur me qendrat që ishin më problematike kemi

zgjedhur ato të cilat mund të restauroheshin me shumën që ne kemi në dispozicion, sepse ne jemi në dijeni të faktit që ka qendra shëndetësore, që kanë nevojë për restaurim total, gjë kjo që kërkon fonde më të mëdha.

Përsëri **Z.Sokoli** pyet, nëse Bashkia Shkodër ka ndonjë plan afatgjatë për të mbuluar restaurimin e qendrave të tjera shëndetësore?

Përgjigjet **Znj.Kruja**, patjetër që ka. Në buxhetin e ardhshëm do mundohemi të krijojmë mundësi, pse jo edhe me bashkëfinancime dhe sigurim fondesh të tjera për të plotësuar kushtet e qendrave, që kanë më shumë nevojë për investim.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **28** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: *Pr/Vendim: "Për strehimin emergjent të Znj.XH.B dhe fëmijëve të mitur në njësinë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare "Për familjen"Nr.6 (ish konvikti i Shkollës Pyjore).*

Znj.Pode merr fjalën dhe shprehet se kjo pikë nuk ka nevojë të relatohet, pasi tashmë dihet që situata në fjalë është emergjente dhe shumë delikate.

Kryetarët e grupeve politike shprehen pro Pr.Vendimit.

Pr/akti hidhet në votim . ku rezultojnë **28** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika e rradhës, pika nr.6: *Pr/Vendim: "Dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga subjekti "Raiffeisen Invest", sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investim dhe zbatim në kuadër të "Rikualifikimit të hyrjes së disa shkollave të qytetit, Shkodër.*

Relaton për këtë pr/vendim Zv/kryetari **Z.Bejleri**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Mirsad Bashi merr fjalën dhe shprehet se ndoshta është më i nevojshëm restaurimi i shkollave në fjalë sesa thjesht lyerja dhe sistemimi i hyrjes.

Përgjigjet **Z.Bejleri** sqaron se ky është një investim krejtësisht i "Raiffeissen Invest" dhe e mirëpresim pavarësisht çfarë ofrohet.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Znj.Pode po ashtu shprehet dakort.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **27** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën e parë shtesë të rendit të ditës: *Pr/Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" i ndryshuar.*

Relaton për këtë pr/vendim **Z.Lazri**, Këshilltar pranë kabinetit të Kryetarit të bashkisë, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Pode në cilësinë e kryetarës së komisionit të rendit dhe mbrojtjes publike e sheh këtë pr.vendim shumë të rëndësishëm dhe fton kolegët këshilltarë ta votojnë atë.

Kryetarët e grupeve politike shprehen pro Pr.Vendimit.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **29** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën e fundit shtesë të rendit të ditës: *Pr/Vendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarret"*

Edhe për këtë pr/vendim **Znj.Pode** shprehet se nuk ka nevojë për relatin nga ana e administratës dhe as për diskutim, prandaj kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve, të cilët shprehin dakordësi.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **29** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Znj.Pode merr fjalën përsëri dhe ngre shqetësimin e banorëve për rikostruksionin e rrugës tek ish uzina "Drini", rreth 70 m rrugë, në fshatin Rrenc.

Kurse **Znj.Gjekaj** kërkon vëmendje të shtuar në segmentin e rrugës. At.Shtjefen Gjeçovi nga Policia bashkiake lidhur me parkimet aty, pasi krijohen probleme gjithmonë.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 31.07.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban ____faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

